

V E N D I M
Nr.560, datë 1.8.2003

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË
NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË
PRESIDENTIT DHE TË KUVENDIT" DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.726,
DATË 21.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 7, shkronja "b" në paragrafin e shtatë, "Sekretar i Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Zëvendëskryeministrit, nënkryetarit të Kuvendit" shtohet emërtimi "... sekretar i Komisionit të Kualifikimit Shkencor, III-b".
 2. Në pikën 7, shkronja "b" në paragrafin e fundit "Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit të Presidentit" shtohet emërtimi "... redaktor i gazetës "Mësuesi", IV-a".
 3. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen II-5, në pikën 12, emërtimi "Sekretar i Komisionit të Kualifikimit Shkencor" shfuqizohet.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri "Paga", miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO